



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusha



02 Nr. 68-15  
Me 22.10.2015  
Mamushë

02 No.Nr. 68-15  
Tarikh/Dt. 22/10/2015

Në bazë të Rregullores nr. 08/2015 Riintegrimin e personave të Riatdhesuar dhe menaxhimin e programit per riintegrimin, të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## AKTVENDIM

Për Themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Lokal të ri-integrimit

### I Komisioni Komunal për Riintegrim do të jetë në këtë përbërje:

- |                    |                                     |
|--------------------|-------------------------------------|
| 1. Ilyas Bayraktar | Nënkryetar i Komunës                |
| 2. Cafer Morina    | DAKRS                               |
| 3. Skender Şala    | DBF                                 |
| 4. Agim Morina     | DSHP                                |
| 5. Yalçin Mazrek   | DPUGJK                              |
| 6. Resat Mazrek    | DAP                                 |
| 7. Ganimete Sadiku | Nënkryetare për Komunitete          |
| 8. Ajet Sadiki     | Koordinator i ZKKK                  |
| 9. Ibrahim Morina  | Zyrtar për Integritime Evropiane    |
| 10. Visar Shala    | Zyrtar per komunitete dhe kthim dhe |
| 11. Ylber Kastrati | Zyra Ligjore.                       |

II Kryesues i Grupit Punues eshte z. Ilyas Bayraktar – Nënkryetar i Komunës.

III Detyrat e Komisionit janë ato që janë paraparë me Rregulloren nr. 08/2015 Riintegrimin e personave të Riatdhesuar dhe menaxhimin e programit per riintegrimin

III. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdeset zyra komunale për Komunitete dhe Kthim si dhe të emëruarit.

IV Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë aktvendim njoftohet:

- Zyra për persona të riatdhesuar ne
- Zyra për Komunitete dhe kthim
- Anëtarët e komisionit dhe
- arkivi.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Arif Büttic



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02. Nr. 67 -15

Duke u bazuar ne Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës, nr.03/L-040, neni 13 dhe 58, Udhezimin Administrativ MAPL NR. 02/2014 MAP Nr. 01 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna si dhe neni 82 të Statutit të Komunes së Mamushës të datë 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë :

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
No.Nr.	02 67-15	
Tarih/Dt.	15.10.2015	

**VENDIM**  
(Për emërimin e Shefit të Kabinetit)

I. Z. Mirat Bitiçi, i lindur me datë 10/09/1996 në posedim të leternjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës me nr. Personal 1232058257, EMËROHET Shef i Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës.

II. I emëruari sipas pikës I të këtij vendimi do të ushtërojë të gjithat detyrat dhe përgjegjësitë sipas përshkruimit për pozitën: Shef i Kabinetit.

III. Paga e të cekurit do të jetë sipas neni 3 paragrafi 1.3 të Udhezimit Administrativ MAPL NR. 02/2014 MAP Nr. 01 për caktimin e stafit mbështetës në Komunadhe atë në shumën 420.00€ (katërqind e njëzet euro) si dhe Vendimit të Qeverisë nr.01/176 dt. 10.03.2014.

IV. I emëruari fillon punën me datë 14/10/2015, ndërsa kohëzgjatja e emërimit është e lidhur me mandatin e Kryetarit të Komunës, nëse kjo mardhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

V. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa paga do të realizohet nga kategoria ekonomike: Paga dhe mëditje.

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ti dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyra e Personelit;
- Z. Mirat Bitiçi dhe
- arkivit.





02 Nr. 66 -15  
Me datë 15.10.2015

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamushë
02	No.Nr. <u>66 - 15</u>
Tarih/Di.	<u>15.10.2015</u>

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L040, nenit 82.7 të statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 dhe rregulloreve të prokurimit publik, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## V E N D I M

### Neni I

Emërohet z. **Yüksen Topoyani**, Menaxher i kontratës për lëndën me titull: "NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS MAMUSHË-SMAQ-AUTOSTRADË"-FAZA E PARË - RITENDER me numër të Prokurimit: **526/15/023/521**, ndërsa Mbikëqyrës i Projektit në lë emërohet: z. **Samil Pireci**, ing. I dpl. I ndërtimtarisë.

### Neni II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i Kontratës do të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës dhe Operatorit Ekonomik.

Menaxheri i Kontratës, brenda 2 ditëve të punës, do ta përcjell një kopje të planit për menaxhimin e kontratës departamentit të prokurimit.

### Neni III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës:

- Menaxhon obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë; dhe
- Siguron që operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në Kontratë.

### Neni IV

Funksionet e Menaxherit të Kontratës janë:

- Të siguroj që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Të siguroj që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.
- Të siguroj që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me terma dhe kushtet e kontratës.
- Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- Të siguroj që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- T'i siguroj detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës zyrës së Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës zyrës së Prokurimit; dhe
- T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga zyra e Prokurimit ose nga ZKA.

### Neni V

Menaxheri i Kontratës duhet t'i përmbahet me përpikëri Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

### Neni VI

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe i njëjti i dërgohet:

- Z. Yüksen Topoyani
- Z. Samil Pireci
- Zyrës së Prokurimit
- Operatorit Ekonomik
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa dhe
- Arkivës

Kryetari i Komunës së Mamushës

Arif Büttic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 65/15  
Me 14.10.2015  
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

**V E N D I M**

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

**V E N D I M**

Neni 1

Pas pëlqitjës së gomave dhe detyrimit për rregullim në lokacionin më të afërt, pagesa për furnitorin 'EuroGoma', të bëhet shlyerja e obligimeve për shërbimin e kryer.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë të mirren nga programi Zyra e Kryetarit (16014) në shumën prej 684,80 € dhe programi Infrastruktura Rrugore (18014) në shumën prej 314,40 €, nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.

Neni 3

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit**

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Shërbimeve Publike
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Arif Bütic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality of Mamuša

02	No.Nr. 064-15
Tarih/Dt.	13.10.2015

02. Nr. 064-15

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr.03/L-040, si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datë 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë :

## VENDIM

**Për pagesën për shpenzimet e reklamave për Festivalin e domateve 2015**

**I**  
Të bëhet pagesa për shpenzimet e reklamave për Festivalin e domateve për vitin 2015 nga Komuna e Mamushës në llogari të Junior Print.

**II**  
Me këtë rast lartësia e pagesës do të jete 1000 euro dhe mjetet në fjale do të merren nga donacioni i jashtëm – Raiffeisen Bank, sipas marrëveshjen se sponsorizimit të dates 28.08.2015 konform zotimit numer 1029903 dtae 07.10.2015, respektivisht 31/626/18014/130/93502/0111.

**III**  
Ky vendim hynë në fuqi me ditën e marrjes së tij.

Ti dorëzohet:

- Drejtorisë së Sherbimeve Publike;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyra e prokurimit dhe
- arkivit.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

02 Nr. 62 -15

Me 09.10.2015  
Mamushë

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr.	62 - 15
Tarih/Dt		09.10.2015

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 nenit 35.1 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë :

## V E N D I M

### Për lejimin e procedurës pa publikim të kontratës

#### I

Aprovohet kërkesa e Menaxherit të Projektit për lejimin e procedurës pa publikim të kontratës në vlerë prej 512.89 € e cila ka të bëjë me punët shtesë në vlerën nën 10% të projektit me titull “**REN OVIMI I SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË**”-RITENDER, sipas procedurës së prokurimit të udhëhequr me numër rendor të prokurimit: 626/15/024/536,

#### II

Njoftohet zyra e prokurimit të Komunës së Mamushës se pas nënshkrimit të këtij vendimi mund të fillojnë procedurat ligjore sipas LPP-së në lidhje me punët shtesë të projektit në fjalë.

#### III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim do të njoftohet:

1. Menaxheri i Projektit;
2. Punëkryesi;
3. Pala
4. Zyra e Prokurimit
5. Arkiva


**Arif Bütüç**  
Kryetar i Komunës së Mamushës



02 Nr. 61/15  
Me 08.10.2015  
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusha



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## V E N D I M

### Pagesë retroaktive

#### Neni 1

**Aprovohet** kërkesa e Drejtorisë për Arsim dhe Shkenc për pagesë retroaktive znj. Goksen Uyksal Mësimdhënëse pranë Gjinnazit "Ataturk" në Mamushë, e cili ka filluar punën me datë 01.09.2015.

#### Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë të dedikuar për periudhën 01.09.2015 deri më 30.09.2015 në shumën prej 442,26 € nga kategoria paga dhe mëditje.

#### Neni 3

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit**

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Arsim dhe Shkenc
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 60/15  
Me 08.10.2015  
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## V E N D I M

### Pagesë retroaktive

#### Neni 1

**Aprovohet** kërkesa e Drejtorisë për Arsim dhe Shkenc për pagesë retroaktive znj. Fatmie Berisha Mësimdhënëse pranë Shk.Fill "Anadolu" në Mamushë, e cili ka filluar punën me datë 01.09.2015.

#### Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë të dedikuar për periudhën 01.09.2015 deri më 30.09.2015 në shumën prej 405 € nga kategoria paga dhe mëditje.

#### Neni 3

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit**

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Arsim dhe Shkenc
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës







Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuša

02 Nr. 59/15  
Me 08.10.2015  
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

**V E N D I M**

**Pagesë retroaktive**

**Neni 1**

**Aprovohet** kërkesa e Drejtorisë për Arsim dhe Shkenc për pagesë retroaktive z.Mirat Eren Mësimdhënës pranë Shk.Fill "Anadolu" në Mamushë, e cili ka filluar punën me datë 01.09.2015.

**Neni 2**

Mjetet që lejohen për pagesë janë të dedikuar për periudhen 01.09.2015 deri më 30.09.2015 në shumën prej 405 € nga kategoria paga dhe mëditje.

**Neni 3**

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit**

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Arsim dhe Shkenc
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

02 Nr. 58 -15

Me 08.10.2015  
Mamushë

ÇIKIS - DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING	
02	No.Nr. <u>58-15</u>
Tarih/Dt. <u>08.10.2015</u>	

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë :

## V E N D I M

### Për emërimin e komisionit për pranim teknik

#### I

**Aprovohet** kërkesa e Organit Mbikëqyrës dhe menaxherit të projektit: “**RENOVIMI I SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË**”- RITENDER i udhëhequr me numër rendor të prokurimit: 626/15/015/136, për emërimin e komisionit për pranim teknik të projektit të lartcekur:

#### II

Komisioni përbëhet prej tre anëtareve, si më poshtë:

1. Faruk Taç – Kryesues i komisionit
2. Ajet Sadiki - anëtar
3. Besire Gjini- anëtare

#### III

Komisioni pas daljes në vendin e ngjarjes do të hartoj një raport me shkrim në lidhje me gjendjen teknike të realizimit të projektit duke u bazuar në Kontratë dhe paramasat e projektit.

#### IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim do të njoftohet:

1. Menaxheri i Projektit ;
2. Punëkryesi;
3. Drejtorja e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
4. Zyra e Prokurimit
5. Arkiva

Arif Bütüç  
Kryetar i Komunës së Mamushës



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 57-15  
Me 07.10.2015  
Mamushë

Cikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 57-15
Tarih/Dt. 07/10/2015	

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042, Rregulloreve të Prokurimit Publik si dhe nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## V E N D I M

### Për emërimin e komisionit për pranim teknik

#### I

Aprovohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për emërimin e **komisioni për pranim teknik të punimeve për** projektin “Ndertimi i rruges Bahcelik me kubza betoni – me nr. prokurimi 626/15/008/521”

#### II

Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

1. Esra Osi – Kryetar e komisionit;
2. Haşim Morina – Anëtar dhe
3. Erdinç Morina – Anëtar.

#### III

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
2. Furnizuesi;
3. Palës;
4. Zyra e Prokurimit dhe
5. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 56 -15  
Me 01.10.2015  
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

## V E N D I M

**Për emërimin e komisionit për pranim teknik**

### I

Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizem dhe Gjeodezi Kadaster për emërimin e komisioni për pranim teknik të punimeve për projektin “Rregullimi i Shkolles se Mesme dhe Parqeve në Mamushë – me nr. prokurimi 626/14/018/521”

### II

Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

1. Hevzi Mazrek – Kryetar i komisionit;
2. Nüsret Morina – Anëtar dhe
3. Esra Osi – Anëtar.

### III

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo	
	Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
	Çikis - Dalëse - Iziarna - Çuigong	
02	No.Nr. <u>56-15</u>	
	Tarih/Dt. <u>01.10.2015</u>	




Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Planifikim, Urbanizem dhe Gjeodezi Kadaster;
2. Furnizuesi;
3. Palës;
4. Zyra e Prokurimit dhe
5. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo	
	Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr. 063-15	
Tarih/Dt. 12.10.2015		

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

02 Nr. 063-15

Me 12.10.2015  
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë :

## V E N D I M

### Për dislokimin e punëve të mbetura

#### I

Aprovohet kërkesa e Menaxherit të Kontratës për projektin “NDËRTIMI I RRUGËS “BAHÇELIK” ME KUBËZA TË BETONIT” i udhëhequr me numër rendor të prokurimit: 626/15/008/521 për dislokimin e punëve të mbetura.

#### II

Punët e mbetura do të vazhdojnë të kryhen në rrugën “Demirci” në Mamushë e cila gjendet afër shkollës fillore “Anadolu”

#### III

Të gjitha punët do të kryhen me çmimin e kontraktuar për projektin në fjalë, organi mbikëqyrës dhe menaxheri i projektit do të barazojnë gjendjen e punëve të kryera me ato të mbetura, e që do të kryhen në vendin e cekur në nenin 2 më lartë.

#### IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

## ARSYETIM

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, ka shpallur tenderin me titull: “NDËRTIMI I RRUGËS “BAHÇELIK” ME KUBËZA TË BETONIT”. Pas nënshkrimit të kontratës Operatori Ekonomik si kontraktues i ka filluar punimet në kohën e duhur, mirëpo gjate

ekzekutimit të punimeve ka hasur në pengesa nga ana e qytetarëve për shkak të problemeve pronësore juridike.

Në pamundësi të zgjidhjes së problemeve pronësore juridike dhe me qenë se punët janë kontraktuar, Menaxheri i kontratës, me datë 09.10.2015 ka bërë kërkesë për dislokimin e punëve të mbetura nga projekti në fjalë në ndonjë vend tjetër të nevojshëm.

Pas konsultimit me drejtorin e drejtorisë së shërbimeve publike u vendos që punët e mbetura për shkak të problemeve pronësore juridike të dislokohen në rrugën "Demirci" në Mamushë e cila gjendet afër shkollës fillore "Anadolu"

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Me këtë vendim do të njoftohet:**

1. Menaxheri i Kontratës në fjalë;
2. Organi Mbikëqyrës i projektit në fjalë;
3. Punëkryesi;
4. Zyra e Prokurimit
5. Drejtoria e Shërbimeve Publike
6. Arkiva

Arif Bütüç  
Kryetar i Komunës së Mamushës

